Në bazë të nenit 36 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 05/02) dhe nenit 12, pika 3 e Ligjit për Gjelbërim Urban ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/18), Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e gjashtëdhjetenjëtë, të mbajtur më 22.12.2020 solli

**PROGRAM OPERATIV VJETOR**
# për ngritjen dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2021

## I. HYRJE

Qyteti i Shkupit ka kompetenca për ngritjen, rregullimin dhe mirëmbajtjen e zonave të gjelbra në territorin e Qytetit të Shkupit, përkatësisht, për gjelbërimin e bulevardeve dhe parqeve, gjelbërim tjetër nën kompetencat e Qytetit, Parkun e Qytetit I dhe II, Parkun e Frankofonisë, Parkun "Zhena Borec" dhe dy anët e bregut në lumin Vardar me një sipërfaqe prej 2,335,499m2, si dhe Park-Pyllin Vodno, Parkun Natyror Gazi Baba dhe QRS Saraj me një sipërfaqe prej 47,026,000m2

Ngritjen e sipërfaqeve të reja të gjelbra, rregullimin e peizazhit hortikulturor dhe rikonstruksionin e hapësirave publike ekzistuese të degraduara, si dhe mirëmbajtjen e zonave të gjelbra publike dhe Park-Pyllit Vodno, Parkut Natyror Gazi Baba dhe SRC Saraj, Qyteti i Shkupit e realizon nëpërmjet NP "Parqe dhe Gjelbërim".

## II. NGRITJA E GJELBËRIMIT TË RI URBAN PËR PËRDORIM PUBLIK DHE RIKONSTRUKSIONI I GJELBËRIMIT TË DEGRADUAR DHE TË PARREGULLUAR

Ngritja e gjelbërimit të ri urban kryhet gjatë ndërtimit të objekteve të infrastrukturës komunale. Rinovimi i gjelbërimit urban kryhet më shpesh gjatë rikonstruksionit dhe ndërtimit të objekteve të infrastrukturës komunale dhe zonave ku gjelbërimi ekzistues ka tejkaluar pjekurinë e tij fiziologjike, si dhe zbukurimit të zonave ku ekzistojnë deponi informale, gërmimeve sipërfaqësore të braktisura dhe hapësirave të pashfrytëzuara. Planifikohet edhe ngritja e kopshteve në çati dhe atyre vertikale, mure të gjelbra dhe gjelbërim mbrojtës si zonë mbrojtëse, si dhe vendosja e pajisjeve urbane

Këtë vit parashikohet ngritja e gjelbërimit të ri urban në hapësira publike dhe rikonstruksioni i gjelbërimit publik në lokacionet e mëposhtme:

1. Rregullimi i hortikulturës në korridorin e gjelbër Bul. "Bosnja dhe Hercegovina" si dhe rikonstruksioni i gjelbërimit anësor ekzistues.
2. Rregullimi i hortikulturës në korridorin e gjelbër rr."Nikola Karev" – nga kazerma Ilinden deri në kryqëzimin Momin Potok.
3. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në rr. "Llazar Liçenoski".

4. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në rr. Brigada Maqedono – Kosovare.
5. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në Bul."Goce Dellçev" – nga udhëkryqi me rr. "Bellasica" deri te sheshi "Skënder Beu" nga të dyja anët.
6. Rregullimi hortikulturorë i sheshit të gjelbërimit prapa ndërtesës "Filatron" nëpër rrugën e re "Eseninova".
7. Rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në rr. "11 Tetori" nga udhëkryqi me bul. "Koço Racin" dhe rr. "Filipi i dytë".
8. Rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në bul. "Klimenti i Ohrit".
9. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i hapësirës së gjelbër – Parkut të Çairit, në bul. "Hristijan Todorovski Karposh".
10. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në bul. "Koço Racin", zhardineria e mesme – nga udhëkryqi me bul. "Kuzman Josifovski Pitu" deri tek udhëkryqi me rr. "11 Tetori".
11. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në bul. KAÇKM – nga udhëkryqi me bul. "Serbia" deri tek udhëkryqi rr. "Pushtimi i shkurtit".
12. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në rr. "Pushtimi i shkurtit" nga bul. "Vidoe Smillevski Bato" deri tek KAÇKM, nga ana e majtë.
13. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i sheshit të gjelbërimit Parku "Maqedonia" në rr. Hristo Tatarçev.
14. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në Parkun e pensionistëve (Draçevë).
15. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në Bul. "Aleksandri i Maqedonisë".
16. Rregullimi hortikulturorë i sipërfaqes publike - sheshit të gjelbërimit në rr. "Vasill Gjorgov" në afërsi të shtëpisë për strehimin e fëmijëve pa prindër "11 Tetori".
17. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i sheshit të gjelbërimit prapa kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
18. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i sheshit të gjelbërimit – Shtëpia e ARM.
19. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i hapësirës të gjelbërimit - park, në mes rr. "Kemal Sejfulla" dhe rr. "Resenska".
20. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në Bul. "Kiro Gligorov".
21. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i hapësirës të gjelbërimit - park në K. Shuto Orizare.
22. Rregullimi hortikulturorë i sipërfaqes së gjelbërimit publik– Parku në mes Bul. "Ilinden" dhe korsisë së këmbësorëve në lumin Vardar, në pjesën e deponisë.
23. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në Bul. "Aradhet Partizane" – zhardineritë nga ana e majtë dhe e djathtë, nga udhëkryqi me rr. "Bledksi dogovor" deri tek udhëkryqi me rr. "Nikolla Parapunov".
24. Rregullimi hortikulturorë i sipërfaqes së gjelbërimit publik– Parku në mes lumit "Lepenec" dhe deponisë së Mavrovës.
25. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i kejit të lumit Vardar nga dyja anët.
26. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në rr. "Boca Ivanova".
27. Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i hapësirës të gjelbërimit në Kalanë e Shkupit.
28. Rregullimi hortikulturorë i korridorit të gjelbërimit në rr. "Skupi".

**Rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i gjelbërimit urban**

Parku i qytetit pjesa I dhe II – do të vazhdohet me rikonstruksionin e gjelbërimit ekzistues me vendosjen e rekuizitave argëtuese për fëmijët dhe i pajisjeve tjera urbane.

Gjithashtu parashikohet edhe rikonstruksioni i gjelbërimit publik në sipërfaqet e parqeve deri te Bulevardet dhe rrugët mbledhëse dhe magjistrale në Qytetin e Shkupit, rikonstruksioni i gjelbërimit për përdorim publik përskaj korsive për biçikleta, si dhe rikonstruksioni i gjelbërimit tjetër për nevoja publik në Qytet, që është me rëndësi të madhe për rekreacionin e qytetarëve,si dhe rikonstruksioni i sipërfaqeve tjera të parregulluara për të cilat do të shfaqet nevoja për rregullimin e tyre për nga aspekti hortikulturorë. Do të realizohet edhe rikonstruksioni dhe rregullimi hortikulturorë i sipërfaqeve të gjelbërimit publik, mbjellja e fidanëve dhe e luleve sezonale, në sipërfaqet që janë nën kompetenca të komunave dhe Qytetit të Shkupit, dhe pas lidhjes paraprake të bashkëpunimeve mes komunale, në mes Qytetit të Shkupit dhe Komunave në qytet.

Do të vazhdohet edhe me mbjelljen e 600.000 luleve në territorin e qytetit të Shkupit, si dhe me furnizimin dhe mbjelljen e 7.000 fidanëve me cilësi të lartë përtëritjen e aleve të drunjve, gjelbërimin publik përskaj bulevardeve, rrugëve magjistrale dhe mbledhëse, si dhe kultivimi i gjelbërimit për nevoja publike në sipërfaqet e parqeve, në rastet kur do të shfaqet nevoja për një gjë të tillë ose në rastet e vjetërsisë së tejkaluar fiziologjike të drunjve.

Gjatë vitit 2021, do të vazhdohet edhe me aktivitetin e prerjes së plepave. Parashikohet që të realizohet prerja e rreth 100 (njëqind) drunjve, për shkak të vjetërsisë së skaduar fiziologjike dhe për shkak të mos përshtatjes së këtij lloji të drurit për mjediset urbane.

## III. REALIZUES I PROGRAMIT OPERATIV VJETOR

Subjekti i detyruar për realizimin e aktiviteteve të parapara me këtë Program është NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup si ndërmarrje publike e themeluar nga Qyteti i Shkupit.

NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, detyrohet që ta realizojë programin të cilin e miraton Këshilli i Qytetit të Shkupit.

## IV. MBIKËQYRJA MBI REALIZIMIN E PROGRAMIT OPERATIV VJETOR

Mbikëqyrjen mbi realizimin e Programit operativ vjetore e kryen Sektori për punë komunale.

Mbikëqyrjen inspektuese mbi realizimin e Programit operativ vjetor e kryen Sektori për punë inspektuese.

## V. FINANCIMI I AKTIVITETEVE TË PARAPARA ME PROGRAMIN

Pjesa e ngritjes dhe rikonstruksionit të gjelbërimit publik financohet përmes programit nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2021, nga zëri JMO 482, shpenzimet kapitale në shumën prej 100.000.000,oo denarë.

Për planifikimin, ngritjen dhe rikonstruksionin e gjelbërimit publike për të gjitha lokalitetet e lartpërmendura, nevojiten mjete financiare në shumën prej 160.000.000,oo

denarë, megjithatë përmbushja dhe realizimi i projekteve të lartpërmendura në pjesën më të madhe do të varet nga kushtet klimaterike për punë.

Financimi i aktiviteteve për planifikimin, ngritjen, mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe rikonstruksionin e gjelbërimit publik, të paraparë me këtë plan, realizohet përmes ndarjes së pjesës prej 19,5 % nga çmimi për ujin e shpenzuar, të faturuar dhe të paguar dhe për mënjanimin e ujërave të zeza urbane.

Qyteti i Shkupit dhe N.P. “Parqe dhe gjelbërime” do të lidhin kontratë në bazë të Programit operativ dhe Planit themelor të planifikimeve, projektimeve, ngritjes, mirëmbajtjes mbrojtëse dhe rikonstruksionit të gjelbërimit në territorin e qytetit të Shkupit.

Çmimet për aktivitetet punuese lidhur me ngritjen dhe rikonstruksionin e gjelbërimit, që i realizon NP “Parqe dhe gjelbërime” janë të përcaktuara në Çmimoren për shërbimet në fushën e hortikulturës, si dhe në Çmimoren e materialit për mbjellje, që janë të miratuar nga Këshilli drejtues i NP “Parqe dhe gjelbërime” dhe për të cilët ka dhënë pëlqim Këshilli i Qytetit të Shkupit.

## VI. DISPOZITA KALIMTARE

Ky program operativ vjetor hyn në fuqi në ditën e shpalljes në “Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit”.